

3661

11.07.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT  
TIRANË

Nr. i Regjistratit Themeltar 7747/3149/972  
Data e Regjistrimit 03.10.2014

Nr. i vendimit 1564  
Data e vendimit 02.06.2016

V E N D I M  
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit, e formuar si trup gjyques, në përputhje me parashikimet e nenit 12, pika 2, shkronja “a”, të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (ligji Nr. 49/2012) dhe shortit të datës 08.04.2016, nga gjyqtarët:

Amarildo	LAÇI	KRYESUES
Lindita	SINANAJ	ANËTARE
Bari	SHYTI	ANËTAR

Asistuar nga sekretarja gjyqësore, **Mimoza Lazri**, në Tiranë, sot në datë 02.06.2016, mori në shqyrtim në **dhomë këshillimi**, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit Nr. 49/2012, çështjen me Nr. 7747/3149/972 akti, datë 03.10.2014, që iu përket:

**PADITËS:** SUBJEKTI “SHKËLQIM ZENUNI”, me seli në lagjen “Barrikadë”, të qytetit të Beratit.

**TË PADITUR:** -DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, BERAT.  
-DREJTORIA E APELIMIT TATIMOR, TIRANË.

**OBJEKTI:** Konstatim i pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore Nr. 3080 Prot., datë 12.11.2013 dhe vendimi Nr. 21461/2, datë 09.04.2014, i Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 49 datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999, Kodi i Procedurës Administrative; Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzim i Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, me vendimin Nr. 1015 datë 08.07.2014, ka vendosur:**

- Pranimin e kërkesë-padisë.
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative:  
Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore Nr. 3080 Prot., datë 12.11.2013 lënë në fuqi me vendimin Nr. 21461/2, datë 09.04.2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.
- Për palët e paditura në mungesë, ky afat fillon nga dita e nesërmës së njoftimit të vendimit.

**Kundër këtij vendimi, në datë 22.07.2014, ka paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit Nr. 1015, datë 08.07.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, dhe rrëzimin e padisë:**

- Vendimi i shkallës së parë është marrë pa bërë një analizë të plotë të prapësimeve që ne kemi paraqitur gjykatës dhe për këtë arsy e kundërshtojmë si më poshtë:
- Penalizmi tatimor është rrjetohojë e vlerësimit nga inspektori i Drejtorisë së Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Berat, në bazë të informacionit të dërguar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut, Berat, dhe verifikimeve të listëpagesës të deklaruar nga vetë subjekti, ku u konstatuan punonjës të padeklaruar përiudhën Nëntor 2013.
- Subjekti "Shkëlqim Zenuni", është penalizuar me gjobë në masën 1 250 000 lekë për mosdeklarim të të punësuarve të gjetur në punë nga inspektori i vlerësimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Berat, bazuar në shkresën Nr. 3034 Prot., datë 30.10.2013, të Policisë Gjyqësore, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Berat.
- Në momentin e kontrollit oficerët e policisë kanë konstatuar 5 (pesë) punonjës, për të cilët është lënë detyrë për verifikime të mëtejshme nga organet tatimore. Bazuar në ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), neni 68 "vlerësimi tatimor" dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24 datë 02.09.2008, pika 68.3.1 është përcaktuar se: Administrata tatimore ka autoritetin dhe detyrimin për të mbikëqyrur të gjithë procesin e vlerësimit të detyrimeve tatimore të personave të tatueshëm.
- Në bazë të dispozitës së sipërcituar, administratës tatimore i lind e drejta e kryerjes së vlerësimit të detyrimit tatimor, i cili bazohet në informacionet që përban deklarata tatimore e tatimpaguesit, rezultatet e kontrollit apo mënyrat alternative të vlerësimit. Më konkretisht në Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, pika 68.3.1 pika (c) theksohet: "c) Kur personi i tatueshëm nuk ka respektuar detyrimin ligjor për të paraqitur deklaratën tatimore. Në këtë rast, vlerësimi i detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore mund të bëhet direkt nga zyra, nëpërmjet përdorimit të metodave alternative të vlerësimit tatimor të përcaktuara në nenin 72 të ligjit dhe në këtë udhëzim." Në zbatim të udhëzimit të sipërcituar pika 72.1, është përcaktuar se: Në përdorimin e metodave alternative të vlerësimit tatimor, administrata tatimore bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke pasur parasysh edhe faktet dhe rrëthanat konkrete të biznesit, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Të

dhënat kryesore ku bazohet gjykimi i administratës tatimore, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:

- a) të dhëna direkte nga deklaratat tatimore të tatimpaguesit apo transaksione të tjera të ngjashme të tatimpaguesit; b) të dhëna direkte, dokumentacione e informacione të marrë nga palët e treta; c) të dhëna, dokumentacione e informacione të marrë nga transaksione të ngjashme të kryera nga tatimpagues të tjerë; ç) të dhëna të tjera indirekte, si konsumi energjisë, karburantit, lëndëve të para, normativave të ndryshme, etj...”
- Në rastin konkret, Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat ka vepruar në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion prej palëve të treta dhe me konkretisht prej informacionit të ardhur nga Policia Gjyqësore, Berat, me shkresën Nr. 3034 Prot., datë 30.10.2013. Nga kontrolli në vendbiznesin e tatimpaguesit, midis të tjerash, janë konstatuar dhe personat që punonin në vendin e biznesit në momentin e kontrollit. Konstatim i cili rezulton të jetë pranuar dhe konfirmuar dhe nga përfaqësuesi i tatimpaguesit.
  - Në bazë të këtij informacioni rezulton se, pasi janë kryer verifikimet e nevojshme në lidhje me deklarimin ose jo të punëmarrësve të konstatuar në punë në momentin e kontrollit, është marrë miratimi nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, Berat, sipas shkresës Nr. 1956, datë 11.11.2013, për vlerësim alternativ.
  - Në lidhje me sa kundërshton vlerësimin tatimor me pretendimin se personat e konstatuar në punë janë të afërt të familjes dhe sezionale, i bëjmë me dije se tatimpaguesit se: Bazuar në ligjin Nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për Mbledhjen e Kontributeve te Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 26, datë 16.04.2009, në zbatim të këtij ligjit.
  - Referuar në Kreun III “Format dhe procedurat e dorëzimit të deklaratave”, germa ”a” pika 1, e Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 26, datë 16.04.2009 është përcaktuar se: Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi dhe të larguarve nga puna, formulari E-SIG 027/a, nga të gjitha subjektet duhet të dorëzohet në dy kopje në protokollin e Drejtorisë Rajonale Tatimore”. Punonjës i protokollit, pasi vendos në formular datën e marrjes në dorëzim, e nënshkruan dhe e vulos dhe një kopje ia jep subjektit përkatës, ndërsa kopja tjetër administrohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore.
  - Pranë organit tatimor nuk është sjellë ndonjë formular E-SIG 027/a për ndryshimin e fuqisë punëtore, por duke qenë se ka ndryshuar mënyra e të punësuarve vetëm nëpërmjet deklarimit elektronik, sqarojmë se në momentin e kryerjes së kontrollit dhe të bërges së verifikimeve në sistemin e deklarimeve, u konstatua se nuk është deklaruar pranë organeve tatimore asnjë prej personave të gjetur në punë në momentin e kontrollit.
  - Nga verifikimet e kryera pranë organit tatimor, është konstatuar se nga ana e subjekti nuk është bërë asnjë lloj deklarimi për personat e sipërpërmendur, çka ka bërë ndjekjen e procedurave të mëtejshme ligjore nga ana e institucionit dhe nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit, objekt ankimi për detyrimet tatimore Nr. 3080 Prot., datë 12.11.2013, me anë të së cilit i është vendosur penalitet, subjektit për mosdeklarim të të punësuarit në vlerën 1.250.000 lekë, bazuar në ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 119, pika 1, germa b, ku shprehet se: “Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përvëç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padëklaruar si më poshtë: a)

tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh; b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, si dhe në Udhëzimin Nr. 24 datë 02.09.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, në nenin 119/1.

- Për sa më sipër, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore Nr. 3080 datë 12.11.2013, nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat si dhe Vendimit Nr. 21461/I datë 09.04.2014, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë, është i mbështetur në ligj, ndaj bazuar në nenin 466/b të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 50 pika c të Ligjit 49 datë 03.05.2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, pala e paditur kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, dhe rrëzimin e padisë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar, ka vendosur: Pranimin e ankimit.

### **GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT,**

Në dhomë këshillimi, si verifikoi se ankimi plotësonte kushtet e pranueshmërisë, në vështrim të nenit 46/2 të ligjit Nr. 49/2012;

konstatoi se palët ndërgjyqëse kishin dijeni rregullisht për shqyrtimin e çështjes, me shpalljen e datës 09.05.2016, në përputhje me përcaktimet e nenit 49/2, fjalia e dytë, të ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 482/2 të K.Pr.Civile;

pasi u njoh me *relacionin e përgatitur nga gjyqtari Amarildo Laçi*,

dhe e shqyrtoi çështjen, brenda shkaqeve të ngritura në ankım, në përputhje me normat ligjore relevante materiale e procedurale,

### **VËREN:**

1. Vendimi Nr. 1015, datë 08.07.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, është rrjedhojë i zbatimit të gabuar të ligjit dhe analizës jo të saktë e koherente të provave të marra në shqyrtimin gjyqësor, ndaj ai duhet të ndryshohet nga Gjykata Administrative e Apelit, në përputhje me germën “c”, të nenit 50 të ligjit Nr. 49/2012.

#### **I. Rrethanat e çështjes**

2. Paditësi, Shkëlqim Zenuni, është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në datë 17.02.2005, si person fizik, me NIPT K52617004Q. Personi fizik e ushtron aktivitetin në qytetin e Beratit, lagjja “Barrikade”, ka si fushë veprimtarie: magazinim, përpunim dhe tregtim ulliri, konservim fruta-perime dhe përpunim vaji të përzier (vaj sallate).

3. Me datë 29.10.2013, Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Berat, kanë mbajtur një procesverbal konstatimi pranë palës paditëse, subjekti fizik “Shkëlqim Zenuni”, ku janë konstatuar pesë punonjës të pasiguruar.

4. Drejtoria e Policisë së Qarkut, Berat, me shkresën Nr. 3094 Prot., datë 30.10.2013, i ka dërguar procesverbalin e konstatimit, palës së paditur, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Berat.

5. Më datë shkresën Nr. 3080 Prot., datë 12.11.2013, njoftim vlerësimi tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) Berat, i ka njoftuar paditësit vlerësimin tatimor, për mosdeklarimin e të punësuarve, duke e dënuar me gjobë në vlerën 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

6. Ndaj këtij vendimi, me datë 05.12.2013, paditësi Shkëlqim Zenuni ka bërë ankrim në rrugë administrative në Drejtorinë e Apelimit Tatimor (DAT), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e Apelimit Tatimor, me vendimin Nr. 21461/2 Prot., datë 09.04.2014, ka vendosur, të lërë në fuqi aktin administrativ objekt ankimi, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore Nr. 3080 datë 12.11.2013, të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Berat, dhe rrëzimin e ankimit.

7. Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat, me kërkësë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Berat, me vendimin Nr. 177 datë 14.04.2014, ka vendosur pushimin gjykimit të çështjes Nr. 143, datë 16.01.2014, në ngarkim të pandehurit Shkëlqim Zenuni, i akuzuar për punësim të paligjshëm, në bazë të nenit 170 të Kodit Penal, për shkak të zbatimit të ligjit Nr. 22/2014, datë 10.03.2014 “Për amnistinë”.

8. Pala paditëse, personi fizik “Shkëlqim Zenuni”, pretendoi pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore, për këto arsyë:

8.1. Së pari, në subjektin e tij nuk ka ardhur asnjë inspektor i drejtorisë së tatimeve, për të kryer verifikimin e fuqisë punëtore.

8.2. Së dyti, nuk ka asnjë akt konstatimi të palës së paditur, DRT Berat, që të disponojë lidhur me kontrollin e ushtruar. Në ambientin ku ai ushtron aktivitetin e tij janë paraqitur dy punonjës policie të cilët e kanë pyetur nëse e kishte të regjistruar objektin dhe për emrat e personave të cilat ishin të regjistruar si të punësuar pranë tij.

8.3. Në procesverbalin e mbajtur nga këta dy inspektori, janë pasqyruar si punëtorë dhe pjesëtarë të familjes, të cilët janë ndodhur aty rastësisht, por që nuk janë punëtorë dhe janë konsideruar si punonjës të pasiguruar.

8.4. Gjoba që i është vendosur subjektit fizik Shkëlqim Zenuni është bazuar në nenin 119, pika 1, germa b, të ligjit “*Për procedurat tatimore*” sipas të cilit: “Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përvëç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padekluar si më poshtë: a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh; tatimpaguesit e tjera, gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh. Për rastet e konstatuara nga zyra të shkeljes së afatit të deklarimit të punonjësve, sipas pikës 1 të këtij nenit, tatimpaguesi dënohet me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo deklaratë të pa dorëzuar apo të dorëzuar jashtë afatit.

8.5. Tatimpaguesi duhet të deklarojë në organin tatimor të larguarit nga puna brenda 10 ditëve nga data e largimit. Për shkeljen e këtij afati, detyrimet vlerësohen deri në datën e deklarimit të tyre në organet tatimore.

8.6. Pala paditëse, personi fizik “Shkëlqim Zenuni” e kundërshton dhe kërkon shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, njoftim vlerësimi tatimor Nr. 3080 Prot., datë 12.11.2013 dhe vendimi Nr. 21461, datë 29.04.2014, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor për këto arsyet:

8.7. Në udhëzimin Nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, në pikën 14.1 parashikohet se, në zbatim të pikës 1 të nenit 14 të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bashkë me Drejtoria Rajonale të saj, është autoriteti i vetëm tatimor qendror në Republikën e Shqipërisë. Si e tillë, ajo është i vetmi autoritet që pranon deklaratat tatimore për tatimet dhe taksat kombëtare, përfshirë deklaratat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vlerëson detyrimet tatimore, kontrollon saktësinë e deklarimit dhe, mbi këtë bazë, përcakton detyrimet tatimore shtesë të një tatimpaguesi dhe rimbursimin apo kthimin e tatimeve të paguara tepër, nëse ka të tillë. Asnjë organ tjeter, përfshirë këtu Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe strukturat e tjera të auditimit të jashtëm, nuk ka të drejtë të kontrollojë, të përcaktojë apo ndryshojë shumën e detyrimeve tatimore të tatimpaguesve të veçantë.

8.8. Është absolutisht i pavlefshëm procesverbali i mbajtur nga policia gjyqësore, Berat, pasi është përpiluar jo nga autoriteti i vetëm që është Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat, por nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Berat.

9.1. Paleta e paditur ka prapësuar se, në bazë të udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, në nenin 68.3.1, pika “c” parashikohet se:

“*Kur personi i tatueshëm nuk ka respektuar detyrimin ligor për të paraqitur deklaratën tatimore, në këtë rast, vlerësimi i detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore mund të bëhet direkt nga zyra, nëpërmjet përdorimit të metodave alternative të vlerësimit tatimor të përcaktuara në nenin 72 të ligjit dhe në këtë udhëzim*”.

9.2. Në nenin 72.1 të këtij udhëzimi parashikohen mënyrat alternative të vlerësimit tatimor sipas të cilës:

“*Në përdorimin e metodave alternative të vlerësimit tatimor administrata tatimore bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke pasur parasysh edhe faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përpunje me legjislacionin tatimor në fuqi.*

Të dhënat kryesore ku bazohet gjykimi i administratës tatimore, por pa u kufizuar vetëm në to, janë: a) të dhëna direkte nga deklaratat tatimore të tatimpaguesit apo transaksione të tjera të ngjashme të tatimpaguesit; b) të dhëna direkte, dokumentacione e informacione të marrë nga palët e treta; c) të dhëna, dokumentacione e informacione të marrë nga transaksione të ngjashme të kryera nga tatimpagues të tjerë; ç) të dhëna të tjera indirekte, si konsumi energjisë, karburantit, lëndëve të para, normativave të ndryshme etj., d) çmimet e referencës së doganës, apo informacione mbi çmimet me pakicë që disponohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në përdorimin e metodave alternative mbahen parasysh edhe dispozitat e pikës 51.3 të këtij Udhëzimi.”

9.3. Sa më sipër, pala e paditur e konsideron të ligjshëm njoftim vlerësimin tatimor.

## **II. Arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë**

10.1. Çështja objekt gjykimi rregullohet nga ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore*” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Udhëzimi Nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” në nenin 68.3.1, pika c parashikon se:

dhe në ligj dhe si i tillë duhet ndryshuar, duke u rrëzuar padia e paditësit, Shkëlqim Zenuni, person fizik.

13. Rezulton e provuar nga tërësia e akteve të administruara në gjykim se: Paditësi ushtron aktivitet tregtar në qytetin e Beratit, në magazinim, përpunim dhe tregtimin e ullirit, konservimin e fruta-perimeve dhe përpunimin e vajit të përzier. Oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat, në datë 29.10.2013, kanë ushtruar kontroll pranë vendit ku ushtron veprimtarinë pala paditëse dhe kanë gjetur duke punuar në momentin e kontrollit, krahas punonjësve të deklaruar në organet tatimore, edhe 5 (pesë) shtetase Thëllëza Çuni, Shkëndi Vokopola, Adelina Gjika, Laureta Cinga dhe Luiza Sallaku.

14. Për këto shtetase në momentin e verifikimit nga policia gjyqësore Berat, paditësi Shkëlqim Zenuni ka deklaruar se i ka punonjëse sezionale dhe i ka të siguruara. Në kundërshtim me sa ka pranuar gjykata e shkallës së parë, ky pretendim i paditësit ka rezultuar i pavërtetë, pasi nga verifikimi që i ka bërë këtyre punonjësve si pala e paditur, DAT Berat, ashtu edhe prokuroria e rrethit gjyqësor, Berat, ka rezultuar se shtetaset e cituara më lart nuk janë regjistruar si punonjëse nga paditësi Shkëlqim Zenuni.

15. Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat në lidhje me këtë konstatim ka njofuar palën e paditur DRT Berat. Inspektori i vlerësimit të DRT Berat pasi ka konstatuar se këto shtetase nuk janë deklaruar si të punësuar pranë palës paditëse, i ka kërkuar Drejtorit të DRT Berat miratimin e vlerësimit tatimore ndaj palës paditëse për periudhën tatimore nëntor 2013 për punonjës të padeklaruar, lidhur me konstatimin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat.

16. Në këto kushte, pala e paditur, DRT Berat, me aktin administrativ-njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr. 3080 Prot. datë 12.11.2013, ka vendosur të gjobisë paditësin Shkëlqim Zenuni me gjobë në shumën 1,250,000 lekë.

17. Paditësi Shkëlqim Zenuni ka ushtruar të drejtën e ankimit sipas ligjit dhe pasi ka shteruar rrugën administrative të ankimit i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, si pasojë e shkeljes flagrante të ligjit nga pala e paditur.

18. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, me vendimin objekt ankimi e ka pranuar padinë me argumentin se jemi një vlerësimi tatimor është absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar në ligj (neni 116/c i Kodit të Procedurave Administrative) me arsyetimin se, që të kryhet një vlerësim tatimor nga zyra nuk mjafton të marren të dhëna nga persona të tretë, por edhe duhet që ato të verifikohen nga organet tatimore.

19. Ky vlerësim i gjykatës së shkallës së parë rezulton të jetë në kundërshtim me rrethanat faktike të provuara në gjykim dhe në kundërshtim me përcaktimet e ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe udhëzimin Nr. 24, datë 02.09.2008, të Ministrit të Financave, i dalë në zbatim të këtij ligji.

20. Gjykata Administrative e Apelit çmon se në rastin objekt gjykimi aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse nuk janë absolutisht të pavlefshme sipas përcaktimeve të nenit 116 të K.Pr.Administrative.

21. Neni 116 i K.Pr.Administrative përcakton se:

*"Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:*

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i pidentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji".

22. Në kuptim të nenit 16 të K.Pr.Civile, cilësimi i saktë i fakteve dhe veprimeve (më saktë i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike) që lidhen me mosmarrëveshjen bëhet nga gjykata që shqyrtan çështjen, ndërsa përcaktimi i bazës juridike të padisë bëhet nga vetë paditësi që me paraqitjen e padisë dhe është në disponimit e plotë të tij ta ndryshojë atë deri në përfundim të hetimit gjyqësor, duke i bërë kërkësë gjykatës në një formë të përshtatshme procedurale. Pra, gjykata duhet të shqyrtojë çështjen sipas objektit të saj, të vlerësojë pavlefshmërinë absolute të pretenduar të aktit administrativ, objekt padie, pa i hyrë gjykimit të çështjes në themel.

23. Paditësi ka gabuar përsa i përket cilësimit të akteve administrative të pëlavë të paditura si absolutisht të pavlefshëm. Që një akt administrativ të konstatohet absolutisht i pavlefshëm duhet të jetë në kundërshtim flagrant me ligjin dhe në kuptim të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative që të jetë në kundërshtim flagrant me ligjin duhet të plotësojë njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) *kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i pidentifikuar:* Që një organ të konsiderohet i njojur nga ligji, ai duhet të jetë pajisur me tagër pushteti, të jetë kompetent për veprimtarinë konkrete administrative që do të kryejë, si dhe të ketë strukturën përkatëse organizativo-administrative. Aktet objekt padie, janë nxjerrë nga palët e paditura, DRT Berat e DAT, të cilat janë organe të administratës publike, me adresë dhe vendndodhje të saktë dhe të përcaktuara në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi, si organe të identifikuara që veprojnë në fushën e tatimeve, që kanë të drejtën e vendimmarrjes lidhur vlerësimet tatimore.

b) *kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore:* Për të ushtruar pushtetin nëpërmjet shfaqjes së vullnetit juridik përkatës, është e nevojshme jo vetëm qenia si një organ i identifikuar i administratës publike, por dhe pajisja nga ligji me tagrat e nxjerrjes së aktit administrativ. Palët e paditura, janë organe administrative të përcaktuara me ligj, si dhe në aktet nënligjore të cilët kanë sanksionuar kompetenca në fushën që mbulon, me qëllim ushtrimin e të drejtave dhe detyrave brenda juridiksonit përkatës. Palët e paditura nuk ka ushtruar kompetenca tej kufijve të ligjit, veprim i cili do të përbente cenim të parimit të ligshmërisë.

c) *kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji:* Respektimi i formës dhe procedurës për nxjerrjen e aktit administrativ përbën një nga elementët më të rëndësishëm që përcakton vlefshmërinë e tij. Shkelja e formës dhe e procedurës mund të paraqitet me të gjitha mënyrat, por e rëndësishme është të kuptohet se jo të gjitha shkeljet që lidhen me formën dhe procedurën mund të shpien detyrimisht në pavlefshmërinë e aktit.

Mosrespektimi i këtyre elementëve duhet të jetë i atij karakteri dhe të asaj rëndësie që të kenë ndikuar drejtpërsëdrejti në nxjerrjen e aktit .

24. Pretendimi i paditësit se procedura e nxjerrjes së aktit administrativ është bërë nga një organ në kundërshtim me formën dhe procedurën e përcaktuar nga ligji, siç korrekësisht e ka ngritur në ankım pala e paditur, DRT Berat, nuk qëndron, pasi siç do të arsyetojmë me poshtë nga pala e paditur është respektuar jo vetëm forma, por edhe procedura e ndjekur në përputhje me ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, dhe udhëzimin Nr. 24, datë 02.09.2008, të Ministrit të Financave, i dalë në zbatim të këtij ligji.

25. Në të kundërt me sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë dhe me të drejtë ka pretenduar në ankım pala e paditur, DRT Berat, rezulton se këto akte janë nxjerrë nga pala e paditur, DRT Berat, në formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji dhe në ushtrim të kompetencave dhe autoritetit të dhënë nga ligji nr. 9920/2008 dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24/2008.

26. Përfundimi i gjykatës së shkallës së parë, se aktet e palës së paditur janë marrë në kundërshtim flagrant me ligjin është i pabazuar në ligj e në prova. Rezulton se masa administrative e marrë nga pala e paditur, DRT Berat, ndaj palës paditëse, Shkëlqim Zenuni, është bazuar në shkeljen e ligjit nr. 9920/2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”.

27. Konkretisht neni 119, pika 1 germa “b”, i këtij ligji përcakton se:

“*Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit, rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike para fillimit të punës, përvëç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributive të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë: ...*

b) *Tatimpaguesit e tjerë me gjobë prej 250.000 lekësh*”.

28. Pala paditëse nuk arriti të provonte se e ka respektuar detyrimin ligjor të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar për deklarimin e punonjësve të punësuar rishtazi të paktën një ditë kalendarike para fillimit të punës. Gjithashu pretendimi i saj se shtetaset Thëllëza Çuni, Shkëndi Vokopola, Adelina Gjika, Laureta Cinga dhe Luiza Sallaku, nuk ka qenë duke punuar në ambientet e palës së paditur është një pretendim i pabazuar, pasi vetë paditësi në procesverbalin e konstatimit, datë 29.10.2013, i ka deklaruar këto shtetase si punonjëse sezionale dhe që i ka të regjistruara në organet tatimore.

29. Gjykata Administrative e Apelit e çmon të pabazuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se pala e paditur në rastin objekt gjykimi ka shkelur procedurën në lidhje me marrjen e masës administrative pasi inspektorët e saj nuk kanë ushtruar kontroll pranë palës paditëse. Rezulton se pala e paditur ka proceduar në rastin konkret në marrjen e masës administrative ndaj palës paditëse, bazuar në ligjin nr. 9920/2008 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 24/2008 dhe konkretisht pikën 72.1 të tij (cituar në paragrafin “9.2.” të këtij vendimi).

30. Pala e paditur, DRT Berat, rezulton se e ka marrë masën administrative ndaj paditësit Shkëlqim Zenuni, bazuar në "Të dhëna direkte, dokumentacione e informacione të marra nga palët e treta". Konkretnisht akti administrativ i palës së paditur është bazuar në kontrollin dhe aktet e konstatimit të dërguara kësaj të fundit nga Drejtoria e Policisë së Qarkut, Berat. Gjithashtu akti administrativ-njoftim vlerësimi tatimor i DRT Berat i është njoftuar rregullisht palës paditëse.

31. Paditësi Shkëlqim Zenuni rezulton se është ankuar pranë palë së paditur, Drejtoria e Apelimit Tatimor, që e ka shqyrtuar ankimin e paditësit dhe ka vendosur rrëzimin e ankimit. Ky vendim i është njoftuar paditësit, i cili ka marrë dijeni rregullisht.

32. Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka zbatuar gabim ligjin (nenin 116/c të K.Pr.Administrative) kur ka konkluduar se aktet administrative objekt gjykimi janë akte administrative absolutisht të pavlefshme.

33. Në analizë të sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon se pretendimet e ngitura në ankım nga pala e paditur, DRT Berat, janë të bazuara në rrëthanat e faktit si dhe në përcaktimet e ligjit dhe, si të tilla, këto pretendime duhen pranuar, duke u vendosur ndryshimi i vendimit të ankumuar dhe rrëzuar padia e paditësit, Shkëlqim Zenuni.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 50, shkronja "c" të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

1. Ndryshimin e vendimit Nr. 1015, datë 08.07.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë:
    - Rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në prova dhe në ligj.
    - Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.
  2. Kundër vendimit mund të ushtrohet rekurs në Kolegin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e shpalljes.
- Ushpall në Tiranë, më 02.06.2016.

A N Ė T A R  
BARI SHYTI  
(d.v.)

A N Ė T A R E  
LINDITA SINANAJ  
(d.v.)

K R Y E S U E S  
AMARILDO LAÇI  
(d.v.)

E njëjtë me origjinalin

Kancela  
Fikra e Tiranës  
J. L.